




22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



ALBANIAN HALAL Expo

Old ways - New visions



EDICIONI I SHTATË - SEVENTH EDITION



PROJEKTI
2027

EXPO
GROUP

KONTAKT:

EXPO GROUP shpk
Rr. Don Bosko, P.TID, No.5, Tiranë,
www.halal.al
+355 67 45 00000



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



SEKTORËT EKSPozUES & EKONOMIA BOTËRORE HALLALL

	Ushqim	Tregu Ushqimor Hallall: 44% e Industrisë Botërore të Ushqimit
		Vlera në nivel botëror: Eur. 1.8 triljon
	Kozmetikë	Tregu Kozmetikës Hallall: 2% e Industrisë Botërore të Kozmetikës
		Vlera në nivel botëror: Eur. 90 miliardë
	Turizëm	Tregu Turizmit Hallall: 5.5% e Industrisë Botërore të Turizmit
		Vlera në nivel botëror: Eur. 230 miliardë
	Farmaceutikë	Tregu Farmaceutik Hallall: 2.5% e Industrisë Botërore të Farmaceutikës
		Vlera në nivel botëror: Eur. 110 miliardë
	Financë	Tregu Financiar Hallall: 68% e Industrisë Botërore të Financës (jo - konsum)
		Vlera në nivel botëror: Eur. 2.8 trilionë
	Life style	Tregu LifeStyle Hallall: 7% e Industrisë Botërore të LifeStyle (Fashion)
		Vlera në nivel botëror: Eur. 300 miliardë
	Edukimi	Tregu Arsimit Hallall: 5% e Industrisë Botërore të Arsimit
		Vlera në nivel botëror: Eur. 200 Miliardë



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



FORMA E APLIKIMIT PËR PJESËMARRJE NË
edicionin e shtatë të
Albanian Halal Expo

TË DHËNAT E KOMPANISË EKSPOZUESE

EMRI					
ADRESA					
QYTETI		SHTETI			
WEB			E-MAIL		
TEL			FAX		
NIPT			KODI POSTAR		
ADMINISTRATORI			Nr. PASAPORTE		
PERSONI KONTAKTIT			Nr. PASAPORTE.		
CELULAR			E-MAIL		


PRODUKTET PËR EKSPOZIM

Emërtimi 1			Emërtimi 4		
Emërtimi 2			Emërtimi 5		
Emërtimi 3			Emërtimi 6		
Çertifikimi(et)	HALLALL		ISO		HACCAP
Data e skadencës	HALLALL		ISO		HACCAP
Emri i Autoritetit Çertifikues Hallall					
Emri i Autoritetit Çertifikues HACCAP					
Emri i Autoritetit Çertifikues ISO					

Emër, Mbiemër	Firmë	Vulë

HALAL EXPO ALBANIA 2027

KOSTOT E PJESMARRJES DHE PLANIMETRIA



KOSTO TE DETYRUESHME

Nr	Përshkrimi I shërbimit	Njesia	Sasia	Çmimi	Shuma	Valuta
1	Stendë në rresht (1 anë e hapur)	M ²		150		Eur
2	Stendë në cep (2 anë të hapura)	M ²		170		Eur
3	Hapësirë Boshe	M ²		120		Eur
4	Hapësirë jashtë	M ²		60		Eur
5	Stendë jashtë (Vetëm si konstrukt)	M ²		30		Eur
6	Taksë Regjistrimi	Taksative		250		Eur

Ju lutem shënoni zgjedhjen time:


Korridori

Sipërfaqja (metra katror)

Stendë në rresht:

Stendë në cep:

Hapësirë boshe





22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



LISTA E ÇMIMEVE PËR SHËRBIMET VULLNETARE

No	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Valuta
1	Siguracioni	Taksë		110		Eur
2	Taksa Regjistrimi Bashkë-Ekspozuesit	Taksë		250		Eur
3	Publikime në katalogun zyrtar					Eur
3.1	Kopertina e pasme		1	800		Eur
3.2	Pjesa e brëndshme e kopertinës së parë		1	650		Eur
3.3	Pjesa e brëndshme e kopertinës së pasme		1	500		Eur
3.4	Faqe e plotë me ngjyra	Copë		320		Eur
3.5	Gjysëm faqe me ngjyra	Copë		200		Eur
4	Banner në: www.expo.halal.al	6 muaj		1200		Eur
5	Shërbime të tjera					Eur
5.1	Stendë e personalizuar	m ²		240		Eur
5.2	Printim Banner	m ²		14		Eur
5.3	Pastrim në stendë	m ² /Ditë		2		Eur
5.4	Hostes	Orë		10		Eur
6	Paisje me qera					Eur
6.1	Tavolinë me syrtarë	Copë		35		Eur
6.2	Tavoline 120x65h75	Copë		25		Eur
6.3	Karrike plastike	Copë		8		Eur
6.4	Ekspozitor 60x50h160	Copë		120		Eur
6.5	Ekspozitor 160x50h100	Copë		80		Eur
Grand Total:						Eur



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



HALAL EXPO ALBANIA – Edicioni I 7të

22-23-24 JANAR 2027

Pallati I Kongreseve

TIRANË - SHQIPËRI

RREGULLORE E PËRGJITHSHME PËR PJESËMARRJE SI EKSPOZUES

Expo Group shpk & AHD shpk

Rr.Don Bosko, P. TID, Nr.5, Tiranë - Shqipëri | Tel: +355 67 45 00000 | e-mail: info@halal.al

Neni 1.

DATA DHE VËNDI I PANAIRIT

Edicioni I shtatë i Halal Expo Albania do të mbahet nga data 22 deri në 24 Janar 2027, në Pallatin e Kongreseve Tiranë. Organizatori ruan të drejtën për të ndryshuar datën dhe kohëzgjatjen e panairit, në përputhje me kërkesat e veçanta teknike dhe nevojat organizative.

Neni 2.

APLIKIMI PËR PJESËMARRJE

Aplikimi për pjesëmarrje, i plotësuar në të gjitha fushat e detyrueshme të tij dhe i nënshkruar nga Ekspozuesi, i dërgohet Organizatorit së bashku me vërtetimin e pagesës së shumës së përcaktuar në Formën e Aplikimit. Organizatori ruan të drejtën e mospranimit të Aplikimeve të cilat nuk janë në përputhje me kushtet për pjesëmarrje në panair. Pranimi i Aplikimit nga Organizatori, nënkupton që Ekspozuesi është njohur dhe dakortuar me Rregullat dhe Rregulloren e Përgjithshme të Panairit. Te gjithë produktet (mallrat) apo shërbimet e prezantuara nga Ekspozuesi duhet të jenë në përputhshmëri me Legjislaturën Shqiptare si dhe me Nomenklaturën e të Mirave Materiale dhe Shërbimeve të aprovuara nga Organizatori. Koordinatorët e Pjesëmarrësve (Ekspozuesve) Kolektivë, janë të detyruar që të informojnë Kompanitë Ekspozuese, pjesë të Pavioneve Shtetërore dhe/ose Grupeve Kolektive, mbi Rregullat dhe Kushtet e Detyrueshme, pjesë integrale në Rregulloren e Përgjithshme. Afati i fundit për Pranimin e Formularit të Aplikimit, është data 10 Janar 2027.

Neni 3

REGJIMI I PËRKOHSHËM DOGANOR

Të mirat materiale (Mallrat) e ekspozuesve të huaj, të cilët vijnë në Panair nëpërmjet Regjimit të Përkohshëm Doganor. Në këtë pike, Expo Group, autorizon një Agjensi Doganore për të ndjekur procedurat e nevojshme për hapjen dhe kryerjen e Regjimit të Përkohshëm Doganor. Nëse një ekspozues, nuk i kryen procedurat doganore në agjensinë e autorizuar nga Organizatori, por i kryen këto shërbime me një tjetër agjensi/operator doganor, Organizatori, nuk e pengon ardhjen e kësaj kompanie në Panair, por nuk lejon që procedura të kryhet në emër të tij (të Organizatorit). Organizatori nuk mban asnjë përgjegjësi në lidhje me vonesat apo grevat, mbërritjet jo në kohë, dëmtimet gjatë transportit apo të ndonjë pretendimi tjetër që rrjedh nga transporti i materialeve ekspozuese në dhe nga Mjediset e Panairit si dhe ndonjë dëmtimi tjetër dhe/ose humbjeje të ndodhur gjatë magazinimit të materialeve ekspozuese apo të ndonjë materiali tjetër në pronësi të Ekspozuesit.

Neni 4

NËNSHKRIMI I HAPËSIRËS SË STENDËS

Nënshkrimi (rezervimi) i hapësirës së stendës do të bëhet nga Organizatori, i cili rezervon të drejtën e ndryshimit të vendndodhjes së stendës si dhe të hapësirës (madhësisë) së ekspozimit, pamvarësisht paracaktimit/përcaktimit të mëparshëm nga Ekspozuesi, vetëm në rastet e nevojave të veçanta tekniko-administrative.

Neni 5.

MONTIMI DHE ÇMONTIMI I STENDËS

Ekspozuesit mund të marrin në dorëzim për pregatitjen e stendës së tyre sipas orarit të më poshtëm:

- a. Hapësirë boshe: duke filluar nga 21 Janar 2027, Ora 08.00-22.00
- b. Stendë standarte: duke filluar nga 21 Janar 2027, Ora 08.00-22.00
- c. Hapësirë e jashtme : duke filluar nga 21 Janar 2027, Ora 08.00-22.00



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



Të gjithë ekspozuesve do t'u kërkohej që të mbarojnë instalimin e stendave të tyre jo më vonë se: 22 Janar 2027, Ora 08.00 A.M.
Të gjitha stendat, dekorimet (zbukurimet) paisjet dhe mallrat, duhet të largohen nga hapësira e panairit jo më vonë se: 25 Janar 2027, Ora 12.00 P.M.
Pas këtij orari, Organizatori do të ndërmarë të gjithë hapat e nevojshëm, me shpenzimet dhe përgjegjësinë e Ekspozuesit, që të largojë paisjet dhe mallrat të cilat nuk janë larguar, si dhe të shkatërrojë çdo element dhe dekorim (zbukurim) të çfarëdolloj tipi/natyre, e/të cila/t nuk janë çmontuar, pa mbajtur asnjë përgjegjësi civile apo penale në lidhje me veprimet sa sipër.

Neni 6.

DITËT E PANAIRIT DHE ORARET

Hapja zyrtare e edicionit të tretë të Halal Expo Albania do të organizohet në 22 Janar 2027, ora 17.30 A.M., në Pallatin e Kongreseve. Gjatë ditëve të ekspozimit, Panairi do të jetë i hapur për vizitorët sipas orarit të mëposhtëm:

- E Premte, 22 Janar 2027: 12:00 me 20:00
- E Shtunë, 23 Janar 2027: 10:00 me 20:00
- E Diel, 24 Janar 2027: 10:00 me 20:00

Neni 7

GARANCIA E PAGESËS

Palët duhet që shprehimisht të bien dakord me klauzolën që Organizatori është i autorizuar që të pengojë tërheqjen e të mirave materiale/mallrave nga stenda, si një garanci për plotësimin e detyrimeve financiare të cilat rrjedhin nga pjesëmarrja në Panair. Organizatori nuk do të mbajë asnjë lloj përgjegjësie në lidhje me dëmtime eventuale të çfarëdolloj tipi/natyre që mund t'u ndodhin paisjeve/mallrave të cilat gjithashtu janë mbajtur si garanci derisa pagesa e kërkuar nga Organizatori i Panairit të jetë plotësuar. Organizatori ka/ruan të drejtën që të mos konsiderojë kërkesën e Ekspozuesit për mos-pjesëmarrje në Panair, nëse kërkesa është bërë në periudhën pas nënshkrimit dhe pranimit të Formularit të Aplikimit. Në një rast të tillë, shuma e parapaguar nuk do të kthehet.

Neni 8

SIGURACIONI

Vlera e produkteve të ekspozuara në panair, duhet të sigurohet ndaj rreziqeve që mund të ndodhin gjatë zhvillimit të panairit. Organizatori do të mbajë përgjegjësi-garanci në emër të çdo ekspozuesi i cili ka kryer pagesën prej 110 Euro të kërkuara për këtë shërbim. Kjo shumë mbulon primin e siguracionit për Përgjegjësinë Civile ndaj Palevë të Treta. Për çdo sigurim shtesë për të cilin Ekspozuesi ka nevojë, kjo e fundit është e detyruar që të mbulojë vetë shpenzimet për sigurim.

Neni 9

HYRJA DHE DALJA E MATERIALEVE EKSPOZUESE DHE E NJERËZVE NGA SALLA E PANAIRIT

Çdo person i konsideruar si një Ekspozues në Albanian Halal Expo, është i detyruar të mbajë kartën identifikuese (badge) të tij/saj. Në hyrje të panairit, pjesëmarrësve do t'u kërkohej të tregojnë-vërtetojnë identitetin e tyre personal dhe profesional. Të mirat materiale që do të ekspozohen si dhe materialet e tyre shoqëruese, duhet të jenë në përputhje me Nomenklaturën e Mallrave dhe Shërbimeve të aprovuar nga Organizatori. Mallrat (mostrat) për ekspozim, lejohen të hyjnë dhe të dalin nga hapësira e panairit vetëm në bazë të një lejeje të shkruar të cilën e lëshon Organizatori. **U ndalohet rrebtësisht Ekspozuesve që të tërheqin/largojnë mallrat ekspozues nga stendat e tyre përpara përfundimit të aktivitetit, datë 24/01/2027.** Largimi i personelit apo tërheqja e produkteve përpara afatit të mësipërm, do të shkaktojë gjobitjen e ekspozuesit me një gjobë me vlerë pesë herë më të lartë se shuma që ka paguar për pjesëmarrje në panair.

Neni 10.

DËMTIMI I HAPËSIRËS SË PANAIRIT

Hapësira e panairit dhe materialet e përdorura për ekspozim, duhet të kthehen në të njëjtat kushte në të cilat u morën në dorëzim, në të kundërt, Ekspozuesi është i detyruar që të paguajë për dëmtimin e kryer, plus një gjobë në masën 20%.



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



Neni 11.

SHËRBIMI I SIGURISË

Organizatori do të sigurojë shërbimin e sigurisë, gjithësesi pa marë përgjegjësi për vjedhje apo dëmtime të mallrave të ekspozuara në stendë apo të magazinuara në hapësirat e panairit. Mallrat (mostrat) e ekspozuara duhet të ruhen nga vetë ekspozuesit gjatë kohës që panairi është i hapur.

Neni 12.

SHËRBIMI I PASTRIMIT

Organizatori do të organizojë pastrimin e kalimeve dhe koridoreve si dhe të hapësirave të tjera të përbashkëta. Pastrimi në stendë është përgjegjësi personale e ekspozuesit por ofrohet si shërbim me pagesë nga Organizatori. Në këtë rast, Ekspozuesi do të ngarkohet financiarisht sipas masës së tarifimit të shprehur në Formularin e Aplikimit.

Neni 13.

REKLAMIMI

Organizatori do të ndërmarë fushatën e reklamimit e cila do të zhvillohet në mas-media, shtyp dhe media elektronike si dhe publikime të tjera, postera, tabela, etj., para dhe gjatë panairit.

Neni 14.

KATALOGU ZYRTAR

Organizatori do të organizojë pregatitjen dhe shtypjen e Katalogut Zyrtar. Ekspozuesit janë të detyruar të furnizojnë Organizatorin me të dhënat e sakta të kompanisë të cilat ai dëshiron që t'i publikohen në Katalog. Organizatori nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për gabime të mundshme apo informacion të munguar të cilat mund të ndodhin gjatë pregatitjes dhe shtypit të Katalogut Zyrtar, apo mos-mundjes të përfshirjes në katalog të çfarëdo materiali të cilët janë dërguar pas afatit përfundimtar të përcaktuar në Rregulloren e Përgjithshme për Ekspozim: 10 Janar 2027. Gjithashtu, nëse do të bëhen ndryshime të të dhënave të kompanisë nga ato të deklaruarat më parë në Formularin e Ekspozimit, këto ndryshime i duhen dërguar Organizatorit me shkrim përpara datës 10 Janar 2027.

Neni 15.

SHËRBIME ME PAGESË

Organizatori ofron shërbimet e mëposhtme me pagesë, në bazë të kërkesave të ekspozuesve:

- a. Transport dhe shërbim doganor;
- b. Sigurimin fizik të të mirave materiale;
- c. Hostes dhe interpretim/përkthim;
- d. Fotografi dhe shërbime audio-vizuale;
- e. Reklamim në Katalogun Zyrtar;
- f. Shërbim promovimi dhe komunikimi;
- g. Shërbim magazinimi;
- h. Organizimi i Eventeve Promocionale;
- i. Akomodimi në Hotel me tarifa preferenciale;
- j. Shërbim i sigurimit fizik me eskortë;
- k. Shërbim i Interpretimit dhe Përkthimit profesional;
- l. Furnizim me energji elektrike 380V;
- m. Furnizim me ujë në stendë;
- n. Paisje shtesë me qera;



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



Neni 16.

RREGULLAT E APLIKUESHME

Kërkohet që Ekspozuesit të njohin dhe të zbatojnë të gjitha rregullat në fuqi gjatë panairit, në veçanti Rregulloren e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Rregullat e Sigurisë Teknike. Çdo ekspozues, me shpenzimet e veta, duhet të pajiset me një fikëse zjarri në stendën e tij.

Neni 17.

KUFIZIME TË PËRGJITHSHME

Ekspozuesit i ndalohej që:

- Të ndërtoje një stendë, apo të vendosë materiale të tjera promovuese mbi lartësinë 2.5m, e cila është lartësia standarte e stendave të panairit, pa aprovim me shkrim nga Organizatori i Panairit.
- Të çmontoje raftet apo të tërheqë mallrat ekspozuese përpara datës dhe orës së përcaktuar nga Organizatori për mbyllje.
- Të kryejë punime në stendë gjatë kohës që panairi është i hapur për vizitorët.
- Të tërheqë vëmendjen e publikut me tinguj apo paisje zëri.
- Të ekspozojë materiale apo të bëjë promocion jashtë stendës së tij.
- Të publikojë apo të përcjellë gjykime kritike të cilat mund të ofendojnë Institucionet Politike apo Shoqërore.
- Të lejojë qëndrimin në stendë të punonjësve të tij pas mbylljes së panairit.
- Të reklamojë në favor, emër dhe/ose për llogari të palëve të treta. Propaganda politike është rrebtësisht e ndaluar gjatë Panairit, përfshirë këtu edhe publikimin e materialeve propaganduese jo-zyrtare dhe të pa-aprovuara nga Institucionet përkatëse Ndërkombëtare.

Neni 18.

TË DREJTAT E IMAZHIT

Filmimet dhe fotografitë e mara (e bëra) në sallë gjatë zhvillimit të panairit, mund të përdoren për të promovuar panairin në media të ndryshme (dokumentarë, televizion, internet, etj). Çdo Ekspozues i cili nuk dëshiron që stenda e tij apo një pjesë e saj apo produktet e ekspozuara në të, të shfaqen në fotografitë apo filmimet e përdorura për promovim të panairit, duhet të informojë Organizatorin me shkrim përpara se panairi të hapet. Përveç kësaj, ekspozuesit që duan të fotografojnë apo filmojnë në panair, duhet t'i dorëzojnë Organizatorit njoftim me shkrim.

Neni 19.

TERMAT DHE MËNYRAT E PAGESËS

Pjesëmarrja, regjistrimi dhe kostot e detyrueshme, si dhe kostot e shërbimeve shtesë (ndihmëse apo sponsorizuese) duhet të paguhet në dy këste: Pagesa e parë e detyrueshme në masën e 60% të totalit të kontratës në momentin e firmosjes së Formularit të Aplikimit, me transfertë bankare apo në CASH, pas marrjes së faturës respektive; Fatura finale për pagesën e pjesës së mbetur të detyrimit duhet t'i dërgohet Ekspozuesit dhe pagesa duhet kryer me transfertë bankare jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë nga data e lëshimit të faturës së përcaktuar më lart. Ekspozuesi duhet të dërgojë një kopje të transfertës bankare jo më vonë se data 10 Janar 2027 me e-mail në: info@halal.al ose në fdajca@halal.al

Neni 20.

LEJIMI I TRANSAKSIONEVE TË SHITJES GJATË PANAIRIT DHE LEGJISTLACIONI NË FUQI

Ekspozuesit që marrin pjesë në Halal Expo Albania janë të lejuar të kryejnë transaksione për shitje dhe blerje në godinën e panairit dhe gjatë zhvillimit të tij, por nëse produktet që shiten janë produkte të vitrinës dhe largimi i tyre dëmton pamjen e stendës, atëherë këto produkte mund të largohen vetëm ditën e çmontimit të stendës. Çdo Ekspozues ka përgjegjësinë që të implementojë me përpikmëri legjislacionin në fuqi duke marrë masa që të ketë NIPT sekondar (dytësor) dhe të përdorë Paisje Fiskale në përputhje me Ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe VKM 781, datë 14.11.2007 "Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale", i ndryshuar.



22-24 JANAR 2027
TIRANË - SHQIPËRI



Neni 21.

PENALITETET E PAGESAVE TË VONUARA

Në rast të pagesave të vonuara, ofrimi i shërbimeve mund të pezullohet. Përveç kësaj, nëse ka detyrime të papaguara në datën e specifikuar në faturën relevante, pamvarësisht nëse shuma e mbetur është e njëjtë ose jo me shumën e specifikuar në termat e përgjithshëm të shitjes, do të aplikohet penalitet në vlerën e një herë e gjysëm të interesave publike plus dy përqind. Këto penalitete do të fillojnë një ditë pas datës së detyrimit final për pagesë si përcaktuar në faturë.

Neni 22.

ANULLIMI I PJESËMARRJES

Nëse aplikanti anullon porosinë e tij për pjesëmarrje në Halal Expo Albania, në më shumë se 60 ditë nga hapja e panairit, shuma e paguar e kështit të parë do të mbahet nga Organizatori. Nëse aplikanti anullon pjesëmarrjen e tij në më pak se 15 ditë nga hapja e panairit, e gjithë shuma e detyrueshme për pjesëmarrje do të mbahet nga Organizatori për dëmin e shkaktuar. Në rast se Ekspozuesi tërhiqet nga pjesëmarrja në Panair, ai duhet të njoftojë Halal Expo Albania nëpërmjet e-mailit zyrtar.

Neni 23.

FORCAT MADHORE

Në rast të Forcave Madhore, siç përcaktohet nga ligji i rastit, nëse Organizatori e ka të pamundur të marrë lokalitetin (Muzeun Historik Kombëtar dhe/ose Sheshin Skënderbej) në mënyrë që të organizojë eventin, Organizatori ruan të drejtën që të anultojë eventin në çdo kohë, me kusht që të njoftojë Ekspozuesit me shkrim për vendimin e tij. Ekspozuesve nuk u lind e drejta për asnjë kompensim apo dëmshpërblim për shkak të një anulimi të tillë. Në këtë mënyrë, shprehimisht dakortohet që Ekspozuesit nuk kanë asnjë të drejtë për padi kundër Organizatorit në asnjë rast dhe për asnjë lloj arsyeje.

Neni 24.

MOSMARRËVESHJET

Me nënshkrimin e Kontratës së Ekspozimit (Formulari i Aplikimit mer vlerë të njëjtë ligjore) palët nënshkruese deklarojnë që ai/ajo ka pranuar me vullnetin e tij/saj të lirë e të plotë të gjitha Dispozitat e Rregullores së Përgjithshme për Ekspozim. Çdo ankesë do t'i dërgohet Organizatorit të panairit me shkrim përpara datës së përfundimit të kontratës. Në rast mospajtimi, teksti në gjuhën Shqipe do të ketë vlerë ligjore.

Në rast se kundërshtitë (konfliktet) nuk do të zgjidhen në një rrugë miqësore midis palëve, Legjislacioni Shqiptar në fuqi do të zbatohet dhe palët do t'i referohen legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 25.

SHTOJCAT DHE NDRYSHIMET

Organizatori rezervon të drejtën të bëjë këmbime apo ndryshime në Rregullat dhe Kushtet e Përgjithshme të cilat mund të ndodhin gjatë fazës së organizimit apo që mund të jenë sugjeruar nga Autoritetet Përgjegjëse respektive. Çdo ndryshim apo shtesë që do të bëhet në Rregulloren e Përgjithshme, do të konsiderohet si pjesë integrale e saj dhe do t'i përcillet Ekspozuesve me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur.

Neni 26

NDALIMI I DUHANIT NË HAPËSIRAT E PANAIRIT

Në zbatueshmëri të ligjit Nr. 9636, datë 05.11.2017 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" ndryshuar me ligjin "Për disa ndryshime në Ligjin Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit" date 10.07.2014, ndalohet rrebtësisht duhan-pirja (tymosja) në "Hapësirat e brëndshme të Panairit dhe Sallat e Konferencave" gjatë kohës së zhvillimit të panairit Halal Expo Albania. Mos-lejimi i duhan-pirjes (tymosjes) në hapësirat e brëndshme të panairit do të njoftohet nëpërmjet shenjave respektive të cilat mbajnë shkrimin dhe logon "NON SMOKING". Ekspozuesit të cilët nuk i binden rregullores do të jenë subjekt penaliteti nga 25 Eur deri në 250 Eur në çdo rast që vërehen. Në rast të vërejtjes së rasteve të tilla gjatë kontrolleve nga Inspektoriati Shëndetësor apo atyre të kryera nga autoritet relevante, AHD shpk çlirohet plotësisht nga çdo përgjegjësi lidhur me çfaredollos shkeljeje të Ligjit për Ndalimin e Duhanit. Të gjitha përgjegjësitë që lindin nga shkelësi/sja mbahen nga ai/ajo.

Data dhe Vendi _____.

Firma dhe Vula _____.



HALAL EXPO ALBANIA – EDICIONI I 7të
22-24 JANAR 2027

PPALLATI I KONGRESEVE

APLIKIMI PËR EKSPOZUES

EXPO GROUP SHPK

Rr. Don Bosko, TID Building

No.5, Tirana - Albania

+355 67 45 00 000

info@halal.al

